

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria Albanian Energy Supplier Sh.p.k (këtu më poshtë “Shoqëria” ose “AES”) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 04 nëntor 2014 pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L42304017T.

Objekti i Shoqërisë është import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike.

Aksioner i vetëm i Shoqërisë është Shoqëria Balfin sh.p.k. e cila zotëron 100% të aksioneve. Që nga 31 dhjetor 2017 Shoqëria administrohet nga Z. Florian Lama.

Adresa kryesore e Shoqërisë është: Rruga “Brigada VIII”, Pallati Nr.19, Kati 3, Zyra 4

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka 14 punonjës (2018: 14).

## **2. BAZA E PËRGATITJES**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”). Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë pasqyrat e para, të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF-të.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, shprehur në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe.

## **3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndryshim. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël, që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar më poshtë.

### ***Tatim fitimi***

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Gjykim i rëndësishëm kërkohet në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt. Shoqëria njihet detyrime për çështje të pritshme të kontrollit tatimor bazuar në vlerësimet se tatime shtesë do mund të lindin si detyrime. Kur rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është ndryshe nga shumat e regjistruara fillimisht, diferencat do të ndikojnë në aktivin dhe detyrimin tatimor aktual dhe të shtyrë në periudhën kur bëhet përcaktimi.

### ***Të ardhurat nga kontratat me klientët***

Shoqëria aplikoi gjykimet e mëposhtme të cilat ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në përcaktimin e shumës dhe kohës për njohjen e të ardhurave nga kontratat me klientët:

#### *i. Identifikimi i detyrimeve të performancës nga tregtimi i energjisë*

Shoqëria është e përfshirë në tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike në tregun e brendshëm. Ajo ka lidhur kontrata shitje dhe furnizimi me klientët, në të cilat premtori shitjen e energjisë sipas kontratave individuale. Shoqëria ka detyrimin të furnizojë blerësit për sasi të dakortësuara në pikat e lëvrimin mes palëve.

### **3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABEL, VLERËSIME DHE SUPOZIME (VAZHDIM)**

Për shitjen e energjisë, transferimi zakonisht ndodh kur sasia aktuale e energjisë injektohet në rrjet dhe matet në pikën e matjes çdo fund-muaji.

#### *ii. Mallra apo shërbime të dallueshme*

Kontratat për furnizimin me energji përbëjnë një detyrim të veçantë të performancës të cilat janë lehtësisht të dallueshme dhe veçmas të identifikueshme. Prandaj Shoqëria cakton çmimin e transaksionit bazuar në çmimin e pavarur të shitjes së shërbimeve.

Shërbimi dhe tregtimi i energjisë është një tip dhe i vetëm ndaj mund të identifikohet në mënyrë individuale me një çmim individual. Çmimi i shitjes mund të identifikohet lehtësisht në kontratat e shitjes. Rrjedhimisht Shoqëria ka alokuar çmimin e transaksionit për secilin rast të shpërndarjes së energjisë në baza individuale duke u bazuar në kontratat me klientë.

#### *iii. Natyra dhe koha e përmbushjes së kushteve të performancës*

Shoqëria ka arritur në konkluzionin që detyrimi i performancës për furnizimin me energji elektrike njihet në momentin e transmetimit të energjisë sipas dorëzimit të skeduleve dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Për të arritur në këtë konkluzion Shoqëria ka vlerësuar nëse:

- Klienti ka rënë dakort me përmbushjen e detyrimit për sasi të dakortësuara
- Furnizimi i energjisë është bërë në përputhje me termat e kontratës (pika e lëvrimit, periudha e lëvrimit, furnizimi sipas skeduleve të dakortësuara)
- Njesisë ekonomike i ka lindur e drejta aktuale për tu paguar për shitjen e energjisë

Shoqëria njeh të ardhurat në baza mujore për energjinë e lëvruar në fund të muajit për çdo klient.

#### *iv. Përcaktimi i shumave të ndryshueshme*

Shoqëria mund të ketë të drejtën e vendosjes së penalteteve për pagesat me vonesë sipas kontratave të saj me klientët, e cila është vlerësuar duke përdorur metodën 'shuma më e mundshme'. Meqë kjo shumë e ndryshueshme nuk konsiderohet e mundshme të ndodhë bazuar në historikun e transaksioneve si dhe në termat e pagesave (brenda 30 ditëve nga data e faturimit), Shoqëria nuk i ka përfshirë këto shuma në çmimin e transaksionit të saj.

#### *v. Kostot e kontratës*

Shoqëria nuk ka kosto të shtuara që lidhen me sigurimin e kontratës me klientë.

#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Polikat kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### **(a) Transaksionet në monedha të huaja**

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë përgatiten në Lekë, e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2019, 31 dhjetor 2018 janë:

<b>Monedha</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

##### **(b) Instrumentat financiarë**

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njësitë ekonomike të Grupit. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letrat me vlerë të kapitalit dhe të borxhit të përdorura gjatë aktiviteteve.

##### **Aktivët Financiare**

###### *i. Njohja dhe matja fillestare*

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike të standartit, Shoqëria mat një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij plus koston e transaksionit, kjo në rastin e një aktivi financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ai duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar. Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si ajo menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregtare nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

###### *ii. Matja e mëpasshme*

Për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me koston e amortizuar (instrumentat e borxhit);
- Aktive financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentat e borxhit);

#### **4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

- Aktive financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pa qarkullimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

##### *Aktivitetet financiare me koston e amortizuar*

Shoqëria ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë. Shoqëria mat aktivet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar të japin rritje në data të përcaktuara për flukset monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivitetet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme tregëtare.

##### *iii. Çregjistrimi*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar është transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon, as mbart, të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

##### *iv. Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Shoqëria merr parasysh supozimin e SNRF se një aktiv financiar konsiderohet si borxh i keq kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë, megjithatë gjykimi bëhet rast pas rasti në varësi të termave të kontratave me klientët dhe historikut të transaksioneve. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale.

Për llogaritë e arkëtueshme, Shoqëria përdor metodën e thjeshtëzuar të përlllogaritjes së humbjeve të pritshme. Si rrjedhim, Shoqëria nuk ruan ndryshimet në riskun e kredisë, por përlllogarit një provigjion për llogari të dyshimta bazuar mbi humbjet e pritshme në çdo datë raportimi. Gjithashtu, Shoqëria analizon informacione të posaçme për klientët e saj, duke përfshirë historikun e pagesave dhe vlerësimin e aftësive paguese. Kryesisht përlllogaritja e humbjeve të pritshme bëhet duke marrë në analizë klientët individualë, duke përdorur metodën e aktualizimit të flukseve të pritshme të parasë.

Të arkëtueshmet nga palët e lidhura përbëjnë 88% të balancës së llogarive të arkëtueshme. Shoqëria vlerëson me siguri të lartë që do arkëtojë llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura, pasi ka njohuri dhe besim të plotë në aftësinë paguese të kompanisë palë të lidhur, por mbi të gjitha të vetë grupit.

##### **Llogaritë e arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme përbëjnë zërin kryesor të aktiveve financiare të Shoqërisë. Një e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për të arkëtuar një pagesë që është e pakushtëzuar (dmth kërkohet vetëm kalimi i kohës para arkëtimit të shumës, pa detyrime të kushtëzuara performance nga ana e Shoqërisë).

#### **4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **Detyrimet Financiare**

*i. Njohja fillestare dhe matja*

Detyrimet financiare klasifikohen në njohjen fillestare si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshme ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në rastin e huave dhe të pagueshmeve neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, dhe të tjera të pagueshme të cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

*ii. Matjet e mëvonshme*

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- me kosto të amortizuar.

*iii. Çregjistrimi*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose shuhen.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

##### **Huamarrjet**

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë e cila përgjithësisht përkon me koston direkte të transaksionit, pra vlerën në para të përfituar.

Pas njohjes fillestare, interesat e huave dhe huamarrjeve maten në vazhdimësi me koston e amortizuar, duke përdorur normën efektive të interesit. Fitimi dhe humbja njihen në pasqyrën e të ardhurave kur detyrimet janë njohur gjithashtu me metodën e amortizimit duke përdorur normën efektive të interesit.

Kostoja e amortizimit llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje apo prim si dhe komisione apo kosto të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit (EIR). Norma efektive e interesit është e përfshirë në kostot financiare të pasqyrës së të ardhurave.

##### **Kostot e huamarrjes**

Kostot e huamarrjes që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një aktivi që domosdoshmërisht merr një periudhë të konsiderueshme kohore për t'u përgatitur për përdorimin ose shitjen e synuar kapitalizohen si pjesë e kostos së aktivitetit. Të gjitha shpenzimet e tjera të huamarrjes shpenzohen në periudhën në të cilën ato ndodhin. Kostot e huamarrjes përbëhen nga interesat dhe shpenzimet e tjera që një njësi ekonomike ka në lidhje me huamarrjen e fondeve.

##### **Kompensimi**

Aktivitetet dhe Detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumatat dhe ka për qëllim ti shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

#### **4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **(c) Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara me maturitet tre muaj ose më pak, të përcaktuara si më sipër e netuar me llogaritë e zbuluara bankare.

##### **(d) Provigjonet**

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

##### **(e) Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet*

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse të të ardhurave (fitim ose humbje) kur ndodhin.

*Leje vjetore e paguar*

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas. Politikat e kompanisë nuk parashikojnë rimbursimin e lejeve të pa shfrytëzuara. Ato duhet të zbatohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

##### **(f) Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

##### **(g) Aktivet afatgjata materiale**

###### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuar (nëse ka).

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

###### *ii. Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese, të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga

#### **4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi llogaritet mbi një bazë lineare mbi jetëgjatësinë e aktiveve si vijon:

▪ Paisje Informatike	4 vjet
▪ Paisje dhe mobilje zyre	5 vjet
▪ Instalime teknike	5 vjet
▪ Godina Nënstacioni	25 vjet
▪ Makineri dhe Pajisje Elektrike	30 vjet
▪ Linja Elektrike	30 vjet

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe çdo pjesë e rëndësishme e njohur në fillim, nuk njihet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme nga përdorimi ose nga shitja e tij.

Çdo fitim ose humbje që vjen nga mosnjohja (ç'regjistrimi) e aktivitetit (llogaritur si diferencë mes të ardhurave nga pakësimi dhe vlerës kontabël të aktivitetit), përfshihet në pasqyrën e të ardhurave kur aktiviteti ç'regjistrohet.

Metoda e Amortizimit, vlera e mbetur e aktivitetit, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen çdo periudhë financiare duke bërë ndryshimet e nevojshme sipas rastit.

Amortizimi i këtyre aktiveve do të fillojë kur ato të jenë të gatshme për përdorim d.m.th. ato të jenë në vendndodhjen dhe në kushtet e nevojshme për tu përdorur në mënyrën e synuar nga drejtimi. Përfitime të ardhshme ekonomike të ndërlidhura me objektin do t'i vijinë Shoqërisë përgjatë jetës së saj të zgjatur, në këtë mënyrë shpenzimi kapitalizohet. Kur pjesë e një aktiviteti nuk konsiderohet në mënyrë të ndarë si një komponent, vlera e zëvendësimit përdoret për të parashikuar totalin e vlerës së aktivitetit që zëvendësohet i cili fshihet menjëherë nga pasqyrat financiare. Të gjitha shpenzimet e tjera për mirëmbajtjen që ndodhin në përditshmëri shpenzohen në momentin që ndodhin.

#### **(h) Zhvlerësim i aktiveve jo financiare**

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohej flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

#### **4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **(i) Të ardhurat nga kontratat me klientët**

###### **Furnizimi me energji**

Shoqëria ka aktivitet kryesor tregtimin dhe furnizimin me energji elektrike si dhe shërbime të tjera të lidhura me to. Të ardhurat nga furnizimi me energji njihen në fund të muajit pas rakordimit mes palëve që bashkëveprojnë në transaksionet e shit/blerjes së energjisë, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të maten me besueshmëri dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. E ardhura njihet me vlerën e drejte të shumës së marrë ose për tu marrë, neto nga kthimet.

Shoqëria konsideron se ka edhe premtime të tjera në kontratë që janë detyrime të performancës të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur.

Në përcaktimin e çmimit të transaksionit për tregtimin e energjisë Shoqëria merr parasysh efektet e konsideratës së ndryshueshme, ekzistenca e komponentëve të rëndësishëm të financimit dhe konsideratës jo monetare.

###### *i. Konsiderata të ndryshueshme*

Zbritjet tregtare trajtohen si konsideratë e ndryshueshme dhe përfshihen në të ardhura kur ekziston probabilitet i lartë që nuk do të ketë ndryshim të konsiderueshëm të shumës së akumuluar të të ardhurave kur pasiguri të ndryshme të çmimit të qartësohen.

Në kontratat që i lejojnë klientit kthimin e shërbimit, të ardhurat do të njihen kur ekziston probabilitet i lartë që nuk do të ndodhë kthim i konsiderueshëm në të ardhurat e akumuluar të njohura. Rrjedhimisht të ardhurat e njohura do të rregullohen për kthimet e pritura, të cilat vlerësohen duke u bazuar në të dhëna historike. Në këto rrethana njihet një detyrim për rimbursim dhe një e drejtë për të rimarrë mallin e kthyer. Shoqëria në bazë të historikut nuk gjykon rrezikun e kthimeve në të ardhmen.

###### *ii. Komponent i rëndësishëm i financimit*

Përgjithësisht Shoqëria nuk operon nëpërmjet parapagimeve me klientët. Dhe në rastet kur operohet nëpërmjet këtyre parapagimeve ato janë për periudha më të shkurtra se 30 ditë, si rrjedhojë kompania nuk bën axhustime në llogaritë përkatëse.

##### **Aktivi i kontratës**

Një aktiv i kontratës është e drejta e njësisë ekonomike për një shumë korresponduese në këmbim të furnizimit me energji elektrike tek klienti. Nëse Shoqëria furnizon me energji elektrike një klient para se sa klienti të paguajë shumën korresponduese ose përpara maturimit të pagesës, aktivi i kontratës njihet për shumën korresponduese e cila është e kushtëzuar. Shoqëria njihet si Aktiv të kontratës llogaritë e arkëtueshme nga klientë.

##### **Detyrimet e kontratës**

Detyrimet e kontratës janë detyrimet e njësisë ekonomike për të furnizuar me energji elektrike klientin për të cilin njësisia ekonomike ka marrë shumën korresponduese (ose ka të drejtë për një shumë korresponduese) nga klienti. Nëqoftëse klienti paguan shumën korresponduese përpara se njësisia ekonomike të furnizojë me energji klientin, një detyrim kontrate njihet kur pagesa është bërë ose është maturuar. Detyrimet e kontratës njihen si të ardhura kur kompania përmbush kushtet e performancës së kontratës.



#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **(j) Qiratë**

*Politika e zbatueshme përpara 1 janar 2019*

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira ose mbajtje qiraje, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkohet një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi specifik ose nëse angazhimi përcjell një të drejtë për përdorimin e një aktivi. Qiratë të cilat nuk i transferojnë Shoqërisë të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e sendeve të marra me qira janë qira operative. Të pagueshmet nga këto qira njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato ndodhin.

*Politika e zbatueshme pas 1 janar 2019*

Shoqëria vlerëson në fillim të çdo kontrate nëse është apo përmban një qira. Kjo ndodh në rastet kur një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar një aktiv të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Shoqëria përdor një qasje të vetme në njohjen dhe matjen e të gjitha qirave, me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe atyre për të cilat aktivi bazë është me vlerë të ulët.

##### **i) Aktiv me të drejtë përdorimi**

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (p.sh. data kur aktivi është i gatshëm për përdorim). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi dhe ndonjë korigjim për rimatjet e detyrimit të qirasë. Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi përfshin detyrimin e qirasë së njohur, kostot direkte dhe pagesat e qirasë të bëra në/përpara datës së fillimit, minus ndonjë stimul qeraje të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet me metodën lineare për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

##### **ii) Detyrimi i qirasë**

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh një detyrim të qirasë së matur me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat, përfshijnë pagesat fikse minus ndonjë stimul qiraje të marrë, pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga ndonjë indeks apo normë e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit, dhe vlerat e pritshme për tu paguar nga qiramarrësi sipas vlerës së mbetur të garancive.

Gjithashtu pagesat e qirasë përfshijnë çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për të ushtruar atë opsion.

Pagesat e qirasë duhet të skontohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi duhet të përdorë normën rritëse të huamarrjes së qiramarrësit. Detyrimet e qirasë përfshihen si huamarrje me interes.

##### **iii) Qiratë afatshkurtra dhe qiratë me vlerë të ulët**

Shoqëria aplikon përjashtimin e njohjes së qirave afatshkurtra për qiratë e apartamenteve dhe paisjeve (psh. qiratë me afat maturimi më të vogël se 12 muaj nga data e fillimit dhe që nuk përmbajnë opsionin e blerjes). Gjithashtu aplikohet përjashtimi për njohjen e qirave me vlerë të ulët (p.sh. paisjet e zyrës). Pagesat e qirasë për qiratë afatshkurtra dhe qiratë me vlerë të ulët janë njohur si shpenzim me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë.

##### **iv) Shoqëria si qiramarrëse**

Qiratë në të cilat Shoqëria nuk merr përsiper të gjitha risqet dhe përfitimet e lidhura me përdorimin e aktivit janë klasifikuar si qira operationale. Shpenzimet nga qiraja kontabilizohen me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë dhe përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas natyrës së operacionit. Kostot fillestare direkte gjatë negociimit dhe caktimit të një qiraje operationale i shtohen vlerës kontabël të aktivit të marrë me qira dhe njihen përgjatë jetëgjatësisë së qirasë sipas së njëjtës metodë.

#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

Efektet e aplikimit të SNRF 16 më 01 Janar 2019 (rritje/rënie) për sa më poshtë:

Shoqëria ka vlerësuar se ka vetëm një marrëveshje të qirasë e cila bie nën qëllimin e trajtimit të IFRS-16. Kontrata për qiranë e përdorimit të automjetit.

Shoqëria gjithashtu ka përdorur:

- Një normë të vetme skontimi për të gjithë portofolin e qirave me karakteristika të njëjta. Norma skontuese e interesit të përdorur është aprovuar në bazë të përqindjes së kostos së huamarrjes në nivel grupi sipas çdo periudhe kohëzgjatje kontrate.
- Ka aplikuar përjashtimin për qiratë afatshkurtra me afat që përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit. Në këtë trajtim kontabël Shoqëria ka përfshirë qiranë e zyrave me një kohëzgjatje 6 mujore.
- Vlerësimin në përcaktimin e afatit të qirasë ku kontrata përmban opsionin e shtyrjes ose përfundim të saj.

#### **(k) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi në depozita bankare apo llogaritë rrjedhëse, dhe fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka). Të ardhurat nga kursi i këmbimit raportohen në bazë neto.

#### **(l) Taksa**

*Tatimi mbi fitimin*

Tatim fitimi përbëhet nga taksa aktuale dhe e shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

*Tatimi të shtyra*

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit financiar, duke rezultuar në diferencë të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anulohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme të taksueshme do të jenë të vlefshme ndaj diferencave të përkohshme që mund të përdoren. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimet e lidhura me atë tatim do të realizohen.

#### **(m) Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël**

Disa amendime të tjera dhe interpretime të zbatuara për herë të parë në 2019 nuk kanë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka zbatuar më herët ndonjë standard, interpretim apo amendim që është nxjerrë, por që nuk ka hyrë ende në fuqi.

## 5. STANDARTET E REJA DHE AMENDIMET E HYRA NË FUQI

Shoqëria ka aplikuar SNRF 16 për herë të parë që nga 1 Janar 2019. Natyra dhe efektet e ndryshimit si rezultat i aplikimit të këtij standarti të ri të kontabilitetit janë përshkruar si më poshtë. Përveç ndryshimeve të përmendura më poshtë, politikat kontabël të zbatuara janë konsistente me ato të një viti më parë.

Disa amendime të tjera dhe interpretime të zbatuara për herë të parë në 2019, por që nuk kanë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka zbatuar më herët ndonjë standart, interpretim apo amendim që është nxjerrë, por që nuk ka hyrë ende në fuqi.

### a. SNRF 16 “Qiratë”

SNRF 16 zëvendëson standardet dhe interpretimet SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një marrëveshje Qiraje, KIS-15 Qiratë e Zakonshme –Stimujt si dhe KIS-27 Vlerësimi i Përbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje. Standardi SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe shpalosjen e qirave dhe kërkon që qiradhënësi/qiramarrësi të kontabilizojë të gjitha qiratë nën një zë të vetëm në bilanc, njëlloj si kontabilizimi për qiratë financiare sipas SNK 17.

Trajtimi kontabël për qiradhënësin sipas SNRF 16 nuk ka pësuar ndryshime, krahasuar kjo me trajtimin sipas SNK 17. Qiradhënësi do të vijojë të klasifikojë qiranë si operationale ose qira financiare duke përdorur të njëjtat parime si tek SNK 17. Prandaj, SNRF 16 nuk ka impakt për qiratë ku Shoqëria është qiradhënëse.

Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standartin duke përdorur një qasje të plotë retrospektive ose një modifikim retrospektiv për çdo periudhë raportimi të paraqitur ose në mënyrë retrospektive, duke njohur efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standarti në datën e zbatimit për herë të parë.

Shoqëria zgjodhi të zbatojë SNRF 16 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar në datën e fillimit të zbatimit të standardit më 01 Janar 2019. Sipas kësaj metode, standardi zbatohet retrospektivisht duke njohur efektin kumulativ në datën e zbatimit për herë të parë të tij. Shoqëria ka zgjedhur të aplikojë standartin duke përdorur metodën praktike të tranzicionit duke mos rivlerësuar nëse një kontratë është apo përmban elemente të qirasë më 1 janar 2019, por vetëm për kontratat që kanë qenë të identifikuar si qira sipas SNK 17 dhe KIRFN 4., gjithashtu ka vlerësuar nëse një kontratë është apo përmban elemente të qirasë.

Kur Shoqëria zgjedh të aplikojë metodën e modifikuar retrospektive, qiramarrësi nuk ritregon shifrat krahasuese. Në vend të kësaj, qiramarrësi njeh efektin kumulativ të zbatimit për herë të parë të IFRS 16 nëpërmjet rregullimit të balancës së celjes së fitimeve të pashpërndara në datën e fillimit të aplikimit, p.sh., 1 janar 2019

Periudha tranzitore e kalimit nga zbatimi i SKK 17 në SNRF 16 konsiston në njohjen e efektit kumulativ të adoptimit fillestar, si një rregullim i çeljes së kapitalit, duke marrë në konsideratë që vlera e aseteve me të drejtë përdorimi është e barabartë me shumën e detyrimit të qirasë, e rregulluar me pagesat e qirasë të marra në avancë.

Menaxhimi ka kryer një vlerësim mbi efektet e zbatimit të standardit të ri SNRF 16 dhe gjykon që zbatimi i këtij standardi ka impaktin si më poshtë për Shoqërinë.

<b>Aktiv me të drejtë përdorimi</b>	<b>Automjete</b>	<b>Total</b>
<b>Më 1 janar 2019 Efekti I zbatimit të IFRS 16</b>	2,626,912	2,626,912
Shtesat		
Amortizimi	(768,852)	(768,852)
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,858,060</b>	<b>1,858,060</b>
<b>TOTAL</b>	<b>1,858,060</b>	<b>1,858,060</b>

**5. STANDARTET E REJA DHE AMENDIMET E HYRA NË FUQI (VAZHDIM)**

Detyrimi i qirasë	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Më 1 janar 2019 Efekti I zbatimit të IFRS 16</b>	2,626,912.44	
Interesi i përllogaritur	74,667	
Pagesat	(647,351)	
Efekti nga kursi këmbimit	(28,721)	
<b>Total</b>	<b>2,025,507</b>	
Detyrim i qirasë afatshkurtër	629,182	
Detyrim i qirasë afatgjatë	1,396,325	
<b>Total</b>	<b>2,025,507</b>	

**b. KIFRN 23 "Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat"**

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushës së veprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me interesin dhe penaltitetet në lidhje me trajtimin e pasigurt të tatimit. Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një entitet i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veçmas;
- Supozimet që një entitet bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore;
- Si një entitet përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore;
- Si një entitet i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një entitet duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë cdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera tatimore të pasigurta. Metodologjia që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë duhet të ndiqet. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzicionit. Shoqëria do të zbatojë interpretimin nga data 1 janar 2019. Meqenëse Shoqëria vepron në një mjedis tatimor në ndryshim, zbatimi i interpretimit mund të ndikojë në pasqyrat e saj financiare dhe në zbulimet e kërkuara. Përveç kësaj, Shoqëria është duke vlerësuar krijimin e proceseve dhe procedurave për të marrë informacionin që është i nevojshëm për të zbatuar interpretimin në kohën e duhur.

Standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet dhe cikli vjetor i Përmirësimeve Vjetore 2015-2017 (lëshuar në Dhjetor 2017) kanë hyrë në fuqi më 1 Janar 2019, megjithatë nuk janë të zbatueshme për Kompaninë.

- Ndryshimet në SNRF 9: Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ,
- Ndryshimet në SNK 19: Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes,
- Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjatë në bashkëpunëtorë dhe Joint venture,

Cikli Vjetor i Përmirësimeve 2015 - 2017, përfshin gjithashtu ndryshimet e tjera vijuese:

- SNK 12 Taksat mbi të Ardhurat - Pasojat tatimore në instrumentet financiare të klasifikuar si kapitali neto
- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit dhe SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta - Interesat e mbajtura më parë
- SNK 23 Kostot e huamarrjes - Kostot e huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim

## 6. STANDARTET E REJA DHE AMENDIMET ENDE JO NE FUQI

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi:

- **Kuadri Konceptual në standardet e SNRF** - IASB lëshoi Kuadrin Konceptual të Rishikuar për Raportimin Financiar në 29 Mars 2018, efektiv për raportimin e periudhave që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020
- **SNRF 3: Kombinimet e Biznesit** - IASB nxori ndryshime në përkufizimin e një biznesi për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në periudhën e parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 Janarit 2020.
- **SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet dhe Gabimet e Kontabilitetit: Përkufizimi i 'materialit'** efektiv për periudhat raportuese që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020
- **Reforma e Standardit të Normave të Interesit - SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7** - efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020 dhe duhet të aplikohen në mënyrë retrospektive.
- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve**, efektive për raportimin e periudhave që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2021
- **Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose Kontributi i Aseteve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose ndërmarrjes së përbashkët**, data e efektshme është shtyrë për një kohë të pacaktuar

## 7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

### Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme dhe të drejtat ndaj Grupit të Shoqërisë.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është paraqitur më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Mjete monetare	33,357,216	9,512,201
Të drejta të arkëtueshme tregtare	282,769,187	509,365,451
<b>Totali</b>	<b>316,126,403</b>	<b>518,877,652</b>

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

Termat e pagesave sipas kontratave janë me afate 30 ditore. Klienti kryesor i Shoqërise është palë e lidhur dhe risku kreditor ndaj tij është i paperfillshëm.

**Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjëndje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm. Gjithashtu, ajo nuk ka detyrime të rëndësishme ndaj palëve të treta.

*Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit*

Aktivitet dhe detyrimet financiare, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

AKTIVE	31 dhjetor 2019				Totali
	deri në 1 muaj	2 deri në 3 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	
Të drejta të arkëtueshme të tjera	158,468,828	122,948,224	1,352,135		282,769,187
Mjete monetare dhe ekuivalentë	27,289,232		6,067,984		33,357,216
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>185,758,059</b>	<b>122,948,224</b>	<b>7,420,120</b>		<b>316,126,403</b>
<b>DETYRIMET</b>					
Hua			79,506,479	52,842,396	132,348,875
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	153,764,109	120,680,502	272,434		274,717,046
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>153,764,109</b>	<b>120,680,502</b>	<b>79,778,913</b>	<b>52,842,396</b>	<b>407,065,921</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>31,993,950</b>	<b>2,267,721</b>	<b>(72,358,793)</b>	<b>(52,842,396)</b>	<b>(90,939,518)</b>

AKTIVE	31 dhjetor 2018				Totali
	deri në 1 muaj	2 deri në 3 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	
Të drejta të arkëtueshme të tjera	303,588,555	205,769,027	7,869		509,365,451
Mjete monetare dhe ekuivalentë		9,512,201			9,512,201
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>303,588,555</b>	<b>215,281,229</b>	<b>7,869</b>		<b>518,877,652</b>
<b>DETYRIMET</b>					
Hua			59,762,629	115,629,193	175,391,821
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	288,436,868	214,906,651			503,343,519
Te pagueshme te tjera afatshkurtra			16,898,929		16,898,929
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>288,436,868</b>	<b>214,906,651</b>	<b>76,661,558</b>	<b>115,629,193</b>	<b>695,634,269</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>15,151,687</b>	<b>374,577</b>	<b>(76,653,689)</b>	<b>(115,629,193)</b>	<b>(176,756,617)</b>

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin. Shoqëria nuk ka ekspozim të lartë ndaj rrezikut të ndryshimit të çmimit të blerjes së energjisë në treg pasi këto luhatje mbikqyren dhe janë pjesë e rregullimit të çmimeve që Shoqëria vendos në kontratat me klientë.

*Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Kjo pasi kompania ka sinkronizuar termat e pagesave mes klientëve dhe furnitorëve. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

AKTIVE	31 dhjetor 2019		
	Lek	Euro	Totali
Të drejta të arkëtueshme tregtare	13,991,060	268,778,126	282,769,186
Mjete monetare dhe ekuivalentë	19,272,778	14,084,438	33,357,216
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>33,263,838</b>	<b>282,862,564</b>	<b>316,126,402</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Hua	-	132,348,875	132,348,875
Të pagueshme tregtare	45,225,115	226,532,685	271,757,800
Të pagueshme të tjera afatshkurtra	-	-	-
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>45,225,115</b>	<b>358,881,560</b>	<b>404,106,674</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>(11,961,277)</b>	<b>(76,018,996)</b>	<b>(87,980,272)</b>
<b>31 dhjetor 2018</b>			
AKTIVE	Lek	Euro	Totali
Të drejta të arkëtueshme tregtare	17,498,029	491,867,422	509,365,451
Mjete monetare dhe ekuivalentë	8,354,279	1,157,923	9,512,201
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>25,852,308</b>	<b>493,025,345</b>	<b>518,877,652</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Hua	-	175,391,821	175,391,821
Të pagueshme tregtare	37,048,653	466,294,867	503,343,520
Të pagueshme të tjera afatshkurtra	5,655,367	11,243,562	16,898,929
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>42,704,020</b>	<b>652,930,250</b>	<b>695,634,270</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>(16,851,712)</b>	<b>(159,904,906)</b>	<b>(176,756,618)</b>

**7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

*Rreziku i normave të interesit*

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut për ndryshime në normat e interesit të tregut lidhet kryesisht me huamarrjen afatgjata që janë me normë interesi të ndryshueshme. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka borxh me normë interesi të ndryshueshme nga bankat.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Instrumentet me normë interesi të ndryshueshme</b>		
Detyrime financiare	132,348,875	175,391,821

Një ndryshim prej 100 deri 300 pikë bazë në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të kishte ndikim të rëndësishëm në rezultatin financiar të Shoqërisë për vitin aktual.

Të ardhurat dhe flukset monetare operative të Shoqërisë janë në mënyrë të konsiderueshme të pavarura nga ndryshimet e normave të interesit të tregut, gjithsesi efekti që një ndryshim në normat e interesit do të kishte në rezultatet e Shoqërisë është rritur për shkak të rritjes në huatë afatshkurtra deri afatmesme, në monedhën LEK, që do të ndikonte në uljen e fitimit para tatimit, si vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Rritje prej 100 Pikë Bazë</b>	1,323,489	1,753,918
Në % të fitimit para tatimit	1.8%	2.2%
<b>Rritje prej 300 Pikë Bazë</b>	3,970,466	5,261,755
Në % të fitimit para tatimit	5.5%	6.5%

*Analiza e ndjeshmërisë*

Me anën e menaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e vazhdueshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2019 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e kursit të këmbimit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhave të tjera me +/- 5% do sillte një ndryshim prej 175 Lek, (2018: 7,995,245 Lek) në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.



**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Shoqëria nuk ka aktive të vendosura si kolateral më 31 dhjetor 2019 dhe të gjitha aktivet janë të lira nga pengesat. Menaxhimi ka vlerësuar në datën e raportimit, duke u bazuar në planet e zhvillimit, që nuk ka tregues të rënies në vlerë, dhe flukset monetare të ardhshme do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar vlerën kontabël të aktiveve të Shoqërisë.

	Godina nënstationit	Makineri dhe Pajisje Energjitike	Linja Elektrike	Instrumenta dhe vegla pune	Paisje informative	Paisje zyre	Ndërtim në proces	Aktive në proces	Totali
<b>Kosto</b>									
<b>Më 1 janar 2018</b>					<b>109,333</b>	<b>63,583</b>	<b>319,579,832</b>	-	<b>319,752,748</b>
Shtesa				252,035	109,125	181,764	609,371	-	1,152,295
Transferime	32,182,197	275,829,964	10,333,005	1,844,036	19,583	(19,582)	(320,189,203)	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>32,182,197</b>	<b>275,829,964</b>	<b>10,333,005</b>	<b>2,096,071</b>	<b>238,041</b>	<b>225,765</b>	-	-	<b>320,905,043</b>
Shtesa		70,980		455,208	427,958	170,442	-	616,850	1,741,438
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>32,182,197</b>	<b>275,900,944</b>	<b>10,333,005</b>	<b>2,551,279</b>	<b>666,000</b>	<b>396,206</b>	-	<b>616,850</b>	<b>322,646,481</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>									
<b>Më 1 janar 2018</b>					<b>13,518</b>	<b>269</b>	-	-	<b>13,787</b>
Amortizimi për vitin	1,072,740	7,661,943	287,028	45,733	76,641	41,434	-	-	9,185,519
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,072,740</b>	<b>7,661,943</b>	<b>287,028</b>	<b>45,733</b>	<b>90,159</b>	<b>41,703</b>	-	-	<b>9,199,306</b>
Amortizimi për vitin	1,287,288	9,200,287	344,434	151,570	114,811	65,093	-	-	11,163,483
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>2,360,028</b>	<b>16,862,230</b>	<b>631,462</b>	<b>197,302</b>	<b>204,970</b>	<b>106,796</b>	-	-	<b>20,362,788</b>
<b>Vlera kontabël neto:</b>									
<b>Më 1 janar 2018</b>					<b>95,815</b>	<b>63,314</b>	<b>319,579,832</b>	-	<b>319,738,961</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>31,109,457</b>	<b>268,168,021</b>	<b>10,045,977</b>	<b>2,050,339</b>	<b>147,882</b>	<b>184,061</b>	-	-	<b>311,705,737</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>29,822,169</b>	<b>259,038,714</b>	<b>9,701,544</b>	<b>2,353,977</b>	<b>461,031</b>	<b>289,410</b>	-	<b>616,850</b>	<b>302,283,695</b>

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**9. QIRATË**

Qiratë në pasqyrën e Pozicionit Financiar përfaqësojnë qiratë operationale të Shoqërise si qiramarrëse, ku është njohur e drejta e përdorimit të aktivit dhe detyrimi i qirasë për gjithë jetëgjatësinë e saj.

<b>Aktiv me të drejtë përdorimi</b>	<b>Automjete</b>	<b>Total</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>		
<b>Më 1 janar 2019</b>	2,626,912	2,626,912
Shtesat		
Amortizimi	(768,852)	(768,852)
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	1,858,060	1,858,060
<b>TOTAL</b>	<b>1,858,060</b>	<b>1,858,060</b>

<b>Detyrimi i qirasë</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
<b>Më 1 janar</b>	2,626,912.44	-
Shtesat		-
Interesi i përlogaritur	74,667	-
Pagesat	(647,351)	-
Efekt nga kursi këmbimit	(28,721)	-
<b>Total</b>	<b>2,025,507</b>	-
Detyrim i qirasë afatshkurtër	629,182	-
Detyrim i qirasë afatgjatë	1,396,325	-
<b>Total</b>	<b>2,025,507</b>	-

**10. PARAPAGIME**

Parapagime afatgjata përfshin parapagimet për qeranë operative 3-vjecare të mjetit të transportit në vlerën 167,824 Lekë.

**11. TË DREJTA TË ARKËTUESHME TREGËTARE**

Llogaria të drejta të arkëtueshme në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Kërkesa për arkëtim nga OST sha	346,164	2,132,958
Kërkesa për arkëtim nga klientët e tensionit të mesëm	13,644,897	15,347,645
Kërkesa për arkëtim nga pjesmarrje në tendera OSHE	19,639,942	
<b>Totali</b>	<b>33,631,003</b>	<b>17,480,603</b>

Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor 30 ditë. Më datë 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka njohur provigjon për të drejtat e arkëtueshme pasi nuk ka patur llogari të pambledhshme deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave. Arkëtimi nga klienti OSHEE, për pjesmarrje në tender është arkëtuar brenda termave të pagesave të kontraktuara mes palëve.

**12. TË DREJTA NDAJ PALËVE TË LIDHURA**

Të arkëtueshme nga njësitë ekonomike brenda grupit në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Albchrome shpk	249,138,183	491,867,422
Green Coast	-	3,885
Green Coast Hotel	-	3,960
Agrocon	-	9,581
<b>Totali</b>	<b>249,138,183</b>	<b>491,884,848</b>

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**12. TË DREJTA NDAJ PALËVE TË LIDHURA (VAZHDIM)**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura përfaqësojnë shumat e pagueshme nga Shoqëritë e grupit për shitjen e energjisë dhe shërbimet e lidhura. Klienti kryesor i Shoqërisë është palë e lidhur, ndaj si pjesë e Grupit kompania nuk gjykon risk likuiditeti.

**13. TË ARKËTUESHME TË TJERA**

Të arkëtueshme të tjera në pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
TVSH e Rimbursueshme neto	22,545,041	44,395,876
<b>Totali</b>	<b>22,545,041</b>	<b>44,395,876</b>

Ligji i ri i TVSH-së në Shqipëri kërkon që Shoqëritë të rimbursohen brenda 30 ditëve nga deklarimi i TVSH-së së tyre të arkëtueshme dhe si rezultat TVSH-ja konsiderohet plotësisht e rikuperueshme në kohën e duhur. Shoqëria ka bërë kërkesë në Tatime për rimbursimin e TVSH për periudhën nëntor – dhjetor 2018, janar 2019 në vlerën 27,995,283 ALL, për të cilën ka përfunduar dhe ka marrë konfirmim nga organet tatimore nëpërmjet raport kontrollit përfundimtar.

**14. PARAPAGIM TATIM FITIMI**

Në zërin tatim fitimi i parapaguar në pasqyrën e pozicionit financiar janë përfshirë të drejtat e Shoqërisë ndaj organeve tatimore për parapagimet e kësteve të tatim fitimit. (Nota nr. 31)

**15. PARAPAGIME DHE TË TJERA AFATSHKURTRA**

Parapagime dhe të tjera afatshkurtra në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Parapagime dhe të tjera afatshkurtra	229,706	13,360
Materiale të tjera	17,250	
<b>Totali</b>	<b>246,956</b>	<b>13,360</b>

Në zërin parapagime dhe të tjera afatshkurtra janë pasqyruar shpenzime faturat e të cilave kanë ardhur në vitin ushtrimor por shpenzimi do të kryhet në vitin pasardhës si dhe parapagime për qerane me afate 6-mujore

**16. MJETE MONETARE**

Paraja në arkë dhe bankë në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Vlera në arkë</b>	<b>83,264</b>	<b>61,599</b>
Arka në leke	36,992	14,699
Arka në euro	46,273	46,900
<b>Vlera në banka</b>	<b>33,273,952</b>	<b>9,450,603</b>
<b>Në Lek</b>	<b>13,167,802</b>	<b>4,839,580</b>
<i>Fonde të Bllokuara AASH</i>	<i>6,067,984</i>	<i>3,500,000</i>
<b>Në Euro</b>	<b>14,038,166</b>	<b>1,111,023</b>
<b>Totali</b>	<b>33,357,216</b>	<b>9,512,201</b>

Fonde te bllokuara AASH (në shumën prej 6,067,984 Lekësh) përfshin fonde të bllokuara në llogarinë bankare të Shoqërisë për një periudhë një vjecare për Operatorin Shqiptar të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) në zbatim të Marrëveshjes për Pjesëmarrje në Tregun e Energjisë Elektrike.

**17. KAPITALI I NËNSHKRUAR**

Shoqëria BALFIN Sh.p.k është aksioneri i vetëm i Shoqërisë me një pjesëmarrje 100%. Aksioneri i vetëm është mbajtësi i së drejtës për përfitimin e dividendëve të ardhshëm, nëse shpërndahen. Gjatë vitit 2019 Shoqëria nuk ka pasur lëvizje në kapitalin aksionar.

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**18. HUA BANKARE**

Më date 24/04/2017 është lidhur një kontratë huamarrje ndërmjet Shoqërisë dhe Bankës Societe Generale me vlerë fillestare 1,500,000 Euro dhe interes Libor EUR 12 MUJOR +3.5%, minimum 3.8%. Kredia është gjithashtu e siguar nga hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme të truallit në pronësi të një kompanie të kontrolluar nga grupi.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Huamarrje Bankare afatgjata	52,842,396	115,629,193
Hua Bankare Afatshkurtër	61,240,979	59,762,628
Hua afatshkurtër me palë të lidhura	18,265,500	-
<b>Totali</b>	<b>132,348,875</b>	<b>175,391,821</b>

Vlera kontabël e huamarrjeve është e përafërt me vlerën e tyre të drejtë meqënëse të gjitha huamarrjet janë marrë me kushte tregu.

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka marrë dhe një kredi afatshkurtër nga Aksioneri i saj në shumën 150,000 Euro, me interes 3% dhe afat maturimi 6 mujor, në përputhje me të gjitha kushtet dhe rregullat e kredimarrjes në treg.

**19. TË PAGUESHME TREGTARE**

Të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime ndaj furnitorëve për blerje Energji elektrike	226,000,795	465,440,899
Detyrime ndaj OST per transmetimin e energjise dhe disbalanca	43,575,316	34,405,779
Detyrime ndaj furnitorëve për shërbime operative	3,543,428	552,558
Detyrime ndaj OSHEE për tarifat e shpërndarjes	1,169,107	2,235,688
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime nga palë të lidhura	428,400	708,595
	<b>274,717,046</b>	<b>503,343,519</b>

Llogaritë e pagueshme përfaqësojnë detyrimet ndaj furnitorëve të energjisë elektrike, si dhe detyrimet ndaj OST dhe OSHE në përputhje me termat e kontratave si dhe detyrimet ndaj palëve të tjera.

**20. TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA**

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura në pasqyrën e Pozicionit Financiar në vitin 2018 (16,898,929 Lekë) përfaqëson kontributin nga ortaku i vetëm Balfin që i është kaluar Shoqërisë për nevojat e aktivitetit të saj. Gjatë vitit 2019 është likuajduar plotësisht ky detyrim ndaj ortakut.

**21. TË PAGUESHME PËR DETYRIME TATIMORE**

Të pagueshme për detyrime tatimore në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tatim në burim	16,588	-
Tatim fitimi	-	6,457,995
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	274,485	222,459
Tatimi mbi të ardhurat personale	105,117	90,516
<b>Totali</b>	<b>396,190</b>	<b>6,770,970</b>

Të pagueshme për detyrime tatimore në pasqyrën e Pozicionit Financiar janë paraqitur detyrimi ndaj autoriteteve tatimore për tatimin në burim për shërbimet e marra me kontratë, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Këto detyrime likuajdohen në janar 2020. Gjatë vitit 2018 në zërin të pagueshme për detyrime tatimore është përfshirë detyrimi për tatimin fitimit e vitit në shumën 6,457,995 Lekë.

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**22. TË PAGUESHME NDAJ PUNONJËSVE**

Të pagueshme ndaj punonjësve në pasqyrën e Pozicionit Financiar përfaqëson detyrimin e Shoqërisë ndaj punonjësve për pagat e papaguara të cilat janë likuiduar në fillim të vitit pasardhës.

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Paga të pagueshme	283,874	893,292
<b>Totali</b>	<b>283,874</b>	<b>893,292</b>

**23. TË PAGUESHME TË TJERA**

Të pagueshme të tjera në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Shpenzime të llogaritura	1,419,814	531,312
<b>Totali</b>	<b>1,419,814</b>	<b>531,312</b>

Shoqëria ka përlogaritur shpenzimet e telefonisë dhe shpenzime për shërbime auditimi të pasqyrave financiare, shpenzimet për Licensë furnizimi dhe Tregtimi 2019 në bazë të kontratave dhe historikut të transaksioneve.

**24. TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTE**

Të ardhurat në pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Shitje Energji elektrike	2,197,233,153	2,267,997,760
<b>Totali</b>	<b>2,197,233,153</b>	<b>2,267,997,760</b>

Të ardhura nga kontratat me klientë përfaqësojnë të ardhurat nga shitja dhe furnizimi i energjisë elektrike.

**25. TË ARDHURA TË TJERA**

Të ardhura të tjera në pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Të ardhura nga Disbalanca pozitive	5,500,666	11,753,221
Të ardhura të tjera operacionale	40,467	45,101
<b>Totali</b>	<b>5,541,133</b>	<b>11,798,322</b>

Të ardhurat nga disbalancat pozitive lidhen me shitjen e energjisë së papërdorur në rrjetin e OST-së.

Në zërin të ardhura të tjera operative janë përfshirë faturat skontuese për shërbime telefonie.

**26. KOSTO E MALLRAVE TË SHITUR**

Kosto e Mallrave të shitur në pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Blerje energji elektrike	1,786,588,312	1,877,456,579
Shpenzime trasmetimi energji elektrike	180,104,532	227,110,821
Shpenzime për shpërndarje energji elektrike	24,866,119	
Disbalanca negative për blerje energji elektrike	91,760,710	70,738,636
<b>Totali</b>	<b>2,083,319,673</b>	<b>2,175,306,036</b>

Zërat e mësipërm lidhen me kostot direkte për blerjen e energjisë elektrike. Kostot nga Disbalancat negative lidhen me faturime nga OST mbi përdorimin e energjisë.

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**27. SHPENZIME TË TJERA SHFRYTËZIMI**

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit në pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime konsulence	5,567,388	4,795,428
Shpenzime licenca dhe rregullimi	2,959,246	313,435
Shpenzime publiciteti dhe reklame	2,107,949	
Shpenzime amortizimi i asetëve me të drejtë përdorimi	768,852	
Qira	726,318	758,040
Shërbime bankare	529,446	397,580
Shërbime të tjera	379,633	668,308
Të tjera	334,545	436,365
Mirëmbajtje dhe riparime	317,383	
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	261,000	38,000
Shpenzime për blerje kancelarie	175,483	2,207
Shpenzime administrative për blerje energjie	149,210	53,970
Tarifa dhe taksa vendore	146,220	158,053
Postare dhe telekomunikacioni	134,513	111,038
Gjoha dhe penalitete	4,210	5,138,066
<b>Totali</b>	<b>14,561,396</b>	<b>12,870,491</b>

Në zërin shpenzime konsulence janë përfshirë shërbimet që ka marrë Shoqëria për konsulencë financiare, juridike gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj si dhe shpenzimet e auditimit të pasqyrave financiare.

Në zërin shpenzime për licenca përfshihen detyrimet e Shoqërisë ndaj Rregullatorit ERE, institucioni përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e politikave mbikqyrëse të tregut të energjisë elektrike. Me qëllim që të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm me energji të klientëve të saj Shoqëria duhet të rinovojë licencat si dhe të paguajë detyrimet ndaj ERE për të qënë pjesëmarrëse në tregun e Energjisë elektrike.

Në zërin shpenzime publicitet reklama janë përfshirë shpenzimet për pjesëmarrje në panair si dhe shpenzimet për publicitet reklama.

Në zërin shpenzime qeraje janë klasifikuar shpenzimet për qera zyra të cilat nuk janë pjesë e objektit të IFRS 16.

Në zërin të tjera përfshihen shpenzime administrative si shpenzime noteriale, siguracione taksa, shpenzime kancelarie etj.

**28. SHPENZIME TË PERSONELIT**

Shpenzime të personelit në pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paga dhe shpërblime	14,369,423	8,774,130
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	1,796,588	1,196,677
Shpenzime të tjera stafi	76,729	-
<b>Totali</b>	<b>16,242,740</b>	<b>9,970,807</b>

**29. TË ARDHURA FINANCIARE**

Të ardhurat financiare në pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitim nga këmbimet valutore	12,116,686	45,046,929
Të ardhura nga interesat	1,670	1,784
<b>Totali</b>	<b>12,118,356</b>	<b>45,048,713</b>

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**30. SHPENZIME FINANCIARE**

Shpenzimet financiare në pasqyrën e të Ardhurave Gjithpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Humbje nga këmbimet valutore	14,606,087	30,307,606
Shpenzime financiare për interesa	5,722,151	5,988,690
Shpenzime financiare për interesa me palë të lidhura	126,852	
Shpenzime interesa mbi detyrimet e qerasë	74,667	
Shpenzime financiare për Garanci Bankare	-	70,743
<b>Totali</b>	<b>20,529,757</b>	<b>36,367,039</b>

Në zërin shpenzime të tjera financiare përfshihen shpenzimet nga fitim humbjet për këmbime valutore, për interesa bankare dhe komisione për lëshimin e garancive bankare në favor të OST si dhe shpenzimet e interesave nga implementimi i IFRS 16 "Qeratë".

**31. TATIM FITIMI**

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2019 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionit Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15%. Nivelin e taksimit për fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2018 ka qenë 15%.

Rakordimi i shpenzimeve të tatimit të fitimit llogaritur me normën e tatimit ligjor mbi fitimin nga aktivitetet operative për Shoqërinë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është paraqitur më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018
Taksa aktuale	4,870,623	6,457,995
Detyrim tatimor i shtyrë	11,374,159	5,804,600
<b>Totali</b>	<b>16,244,782</b>	<b>12,262,595</b>

	Norma e tatimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit		69,075,596	81,144,904
Tatimi fillestar me 15%	15%	10,361,339.36	12,171,736
Efekt i tatimor i shpenzimeve që nuk janë të zbritshme për qëllime tatimore		78,843	779,759
Efekt i tatimor i humbjeve tatimore të mbartura			(688,900)
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>10,440,182</b>	<b>12,262,595</b>

**32. TATIM FITIMI I SHTYRË**

Tatimi i shtyrë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrim tatimore i shtyrë (Shënim 32)	11,374,159	5,804,600
<b>Totali</b>	<b>11,374,159</b>	<b>5,804,600</b>

Shpenzimet për tatim fitimin e shtyrë vijnë si rrjedhojë e diferencës së vlerës kontabël neto dhe bazës tatimore të aktiveve afatgjata materiale (AAM). Shoqëria në përputhje me politikën kontabël zhvlerëson AAM me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së AAM-ve.

Në njohjen e aktiveve vlera e tyre kontabël neto do të rikuperohet në formën e përfitimeve ekonomike që kalojnë tek njësitë ekonomike në periudhat e ardhshme. Meqenëse vlera kontabël e aktiveve tejkalojnë bazën e tyre tatimore, shumën e përfitimeve ekonomike të tatueshme tejkalon shumën që lejon si një zbritje për qëllime tatimore. Kjo diferencë është një diferencë e përkohëshme e tatueshme dhe detyrimi për të paguar tatimet mbi të ardhurat që rezulton në periudhat e ardhshme është një pasiv

**Albanian Energy Supplier Sh.p.k**  
**Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

**32. TATIM FITIMI I SHTYRË (VAZHDIM)**

tatimor i shtyrë. Me rikuperimin nga njësia ekonomike të vlerës kontabël të aktivitetit, diferenca e përkohshme e tatueshme do të rimerret dhe njësia ekonomike do të ketë fitim të tatueshëm. Kjo bën të mundur që përfitimet ekonomike të dalin nga njësia ekonomike në formën e pagesave tatimore. Si rrjedhojë Shoqëria i njeh si pasive tatimore të shtyra.

**33. PALËT E LIDHURA**

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura të Grupit Balfin. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në përputhje me termat tregtare dhe në normat e tregut.

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

*Balancat me palët e lidhura:*

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Të drejta të arkëtueshme me kompanitë motra	249,138,183	491,884,848
Të pagueshme të tjera ndaj kompanisë mëmë		16,898,929
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime me kompaninë mëmë	(418,400)	(668,344)
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime nga kompanitë motra	(10,000)	(40,251)
Hua afatshkurtër me kompaninë mëmë	(18,265,500)	
Mjete Monetare me kompanitë motra	3,256,769	

*Transaksionet me palët e lidhura:*

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
<i>Shitje:</i>		
<i>Kompani motra:</i>		
Të ardhura nga kontratat me klientët	(1,989,637,645)	(2,221,235,723)
Të ardhura të tjera		(45,102)
	<b>(1,989,637,645)</b>	<b>(2,221,280,825)</b>

*Blerje:*

*Kompani motra:*

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Aktive afatgjata materiale	419,528	126,200
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	414,417	204,773
<i>Kompani mëmë</i>		
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	162,275	15,040
Shërbime konsulence dhe të tjera shërbime	4,981,126	4,795,681
Shpenzime për qira	297,181	215,545
Shpenzime për interesa	231,527	
	<b>6,506,054</b>	<b>5,357,239</b>

Shoqëria ka garantuar shyerjen e kredisë bankare nga hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme të truallit me sipërfaqe 34,171m<sup>2</sup> e cila është në pronësi të një kompanie të kontrolluar nga grupi.

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka marrë dhe një kredi afatshkurtër nga Aksioneri i saj në shumën 150,000 Euro, me interes 3% dhe afat muturimi 6 muaj, sipas të gjitha rregullave të kredimarrjes në treg.



### **34. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Gjatë muajit mars 2020, si rrjedhojë e përhapjes së virusit Covid-19, është vendosur gjendje e jashtëzakonshme pandemike globale dhe në Shqipëri. Kjo situatë ndikon çdo biznes në mënyra ende të paparashikueshme, me efekte mbi sigurinë e punonjësve apo mbi zinxhirin e furnizimit dhe prodhimit. Megjithëse kjo situatë impakton mjedisin ekonomik të vendit, Shoqëria ka burime likuiditeti të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e saj operative. Deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave, Kompania ka marrë masat e duhura për të vazhduar aktivitetin e saj kryesor, që është furnizimi i vazhdueshëm me energji elektrike i klientëve të saj dhe nuk ka hasur probleme në furnizimin me energji elektrike duke rezervuar të gjithë kapacitetet e nevojshme. Gjithashtu, situata financiare është e qëndrueshme, llogaritë e arkëtueshme janë mbledhur pothuajse të gjitha pas mbylljes së vitit, dhe gjatë periudhës janar prill 2020 arkëtimi i llogarive të arkëtueshme kanë përmbushur termat e kontratave. Kompania nuk ka detyrime ndaj institucioneve financiare dhe ka likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet tregtare, të personelit dhe ndaj autoriteteve tatimore.

Manaxhimi arriti në përfundimin se gama e rezultateve të mundshme të konsideruara për të arritur në këtë gjykim nuk rrit pasigurinë materiale të lidhura me ngjarje ose kushte që mund të krijojnë dyshime thelbësore mbi aftësinë e Kompanisë për të siguruar parimin e vijueshmërisë. Si rrjedhojë, drejtimi nuk parashikon vështirësi në vijueshmërinë e biznesit të Kompanisë dhe as vështirësi të përkohshme në operacionet e saj.